



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KESHILLI

Nr. \_\_\_\_\_ prot

Koplik më: \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ /2020

**V E N D I M**

*Nr 56 datë 30 / 09 / 2020*

**PËR**

"Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të z. Haxhi Abdyli, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe djegia e plote e Guzhines, si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e këtij shtetasi nga buxheti i bashkisë dhe nga buxheti i vitit 2020 në Ministrinë e Mbrojtjes, programi për "emergjencat civile"

**Baza Ligjore**

Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr. 45/2019 Për mbrojtjen civile,

VKM nr.329 datë 16/5/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"

VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

Me 18 vota pro:

**Vendosi;**

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetasit Haxhi Abdyli, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe djegia e plote e Guzhines.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko - ligjor përkatës të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për dëmtimin e shtëpisë.

3. T'i akordojë familjes së shtetasit Haxhi Abdyli, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit, dhënien e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vlerën/shifren 100.000 (njëqind mijë) lekë nga fondi rezervë i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe vitit 2020.

4. T'i paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të familjes së shtetasit Haxhi Abdyli, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe t'i propozojë/kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC), në Ministrinë e Mbrojtjes për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për shkak të pamundësisë së Bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën financiare, për shkak të mungesës së fondeve nga ana e Bashkisë.



5. Ndhimja financiare për familjen e shtetasit Haxhi Abdyli, përcaktohet sipas kritereve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.

6. Ndhimja financiare që do të akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit **Haxhi Abdyli**, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit.

7. Vlera e dëmeve në orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake është 174.700 (njqind e shtatedhjete e kater mije e shtateqind ) leke. Dëmtime nga ana ndërtimore në vlerën 796.888 (shtateqind e nentedhjete e gjashte mije e teteqind e tetedhjete e tete ) leke.  
Vlera në total e dëmeve është : 971588 (nenteqind e shtatedhjete e nje mije e peseqind e tetedhjete e tete) leke.

8. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

**KRYETAR**

Ilir Halaj

**SEKRETAR**

Emirjan Hasmujaj

Miraturar me 30.09.2020

Vota Pro 18

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 05.10.2020

